




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Bali Muharremaj , Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuçi , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	<i>Për:</i> Elbert Krasniqi , Ministër i MAPL-së Jeton Qela , Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi , Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 17.04.2025 VI-020-193/1
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj , Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Suharekës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 01-Nr-016-31320 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, parcela kadastrale P-72116046-00545-6
I miratuar më datë: 30.05.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.04.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2025, ka miratuar Vendimin 01-Nr-016-31320 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, parcela kadastrale P-72116046-00545-6.

MAPL, konstaton se Vendimi 01-Nr-016-31320 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, parcela kadastrale P-72116046-00545-6i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Suharekës, nuk ka përcaktuar përfitimin ekonomik të komunës.

Ligji Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përcakton si qellim të saj të siguroj shfrytëzimin efektiv të pronës së paluajtshme të komunës, për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, rritjen e vlerës së pronës së paluajtshme të komunës dhe përmbushja e interesit të përgjithshëm. Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim është bërë përmes procedurës së shprehjes së interesit për periudhën afatgjate i cili përcakton si kriter ofertën ekonomikisht më të favorshme. Neni 5 paragrafi 1.3 i këtij Ligji , si dhe nenin 20 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, parashihet se dhënia e pronës komunale në shfrytëzim afatgjate duhet ti plotësoi këto kritere: Vlera e investimit, Numri i të punësuarve nga investimi, Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën, përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës.

Në rastin konkret në Vendimin 01-Nr-016-31320 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, parcela kadastrale P-72116046-00545-6, nuk është përcaktuar cili është përfitimi financiar ekonomik i komunës me rastin e dhënies në shfrytëzim të kësaj parcele.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Suharekës duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.